



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESEM 2022-2024 TË
BASHKISË SHKODËR”.

Konsultim publik : *Banoret e Lagjes nr.3*

Data : 28.10.2021

Ora : 13.00

Vendi: Salla e Këshillit bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 22, nga të cilat 4 gra dhe vajza.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesëm 2022-2024 të bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës: Kryetare e bashkisë znj. Voltana Ademi, Kryetare e Këshillit Bashkiak znj. Brisela Kadija, Kordinator për Njoftimin dhe Konsultimin me Publikun z. Fisnik Lutfija, Inspektorë te lagjeve 3, Banorë të lagjeve, përfaqësues të drejtorive përkatëse të bashkisë Shkodër, si dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Takimi bashkë-drejtohet nga Kryetare e bashkisë dhe Kryetare e Këshillit Bashkiak të cilat bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjeguan qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtuan pyetje konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Udhëzuan për mënyrën e organizimit dhe mbarëvajtjes së takimit, me qëllim arritjen në përfundime dhe rekomandime konkrete për përmirësim.
- ✦ Koordinuan diskutimin ndërmjet pjesëmarrësve;

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

I: ARSIMI PARASHKOLLOR, BAZE, i MESEM i PERGJITHSHEM, PROFESIONAL

1. **Drejtoresha e kopshtit "Fetah Barbullushi"** vlerëson punën e bërë deri tani në kopshtin që ajo drejton..Ajo shprehet se është ndërhyrë në rikonstrukcion, në infrastrukture, në zgjerimin e ambjenteve. Ajo propozon:
 - a. Një rikonstrukcion të tualeteve të kopshtit.
 - b. Të bëhet një ndarje e oborrit.
 - c. Pajisjen e kopshtit me lojra ,në përmirsimin e procesit mësimor.

2. **Znj. Surrila Milloja**,drejtoreshë e shkollës "Branko Kadija" merr fjalën dhe sqaron se shkolla e saj ndër më të mëdhatë, shkolla ka 597 nxënës dhe problemet janë të shumta. Ajo ka bërë kërkesa të përsëritura për nevojat e saj për ndërhyrje: Ajo konkretisht propozon:
 - a. Të bëhet një rikonstrukcion i jashtëm,Lyerje e meremetim.
 - b. Tualetet kanë lagështirë dhe kanë nevojë të ndërhyhet.
 - c. Mungojnë raftet dhe pajisje mësimore.
 - d. Ngrohja vijon me gaz edhe pse është e dëmshme dhe nuk kemi person përgjegjës për këtë.
 - e. Edhe në lidhje me oborrin e shkollës kemi shumë pakënaqesi sepse është i pa rrethuar dhe shpesh herë sjell problem fakti që persona të huaj hyjnë,Kemi ankesa edhe nga prindërit.
 - f. Mungojnë rojet,kemi bërë ankesa papushim në bashki,por pa përgjigje.Rojet nuk paraqiten në punë dhe si pasojë çënohet siguria në shkollë.
 - g. Oborri në mot të keq,mbushet me ujë dhe bëhet i pakalueshëm.
 - h. Edhe hyrje –daljet e përsoneve te huaj janë kthyer problem shumë shqetësues për ne dhe për prindërit.
 - i. Edhe një pikë shitje ambulante në oborrin e shkollës sjell problem tjera.
 - j. Të rrethohet oborri ndoshta mund të jetë zgjidhja.

3. **Z.Artur Koçija**, banor i lagjes nr.3 merr fjalën dhe shprehet se për fëmijët e kopshtit duhet të tregohet kujdes i veçantë. Ai propozon:
 - a. Të rregullohet problem i ngrohjes.
 - b. Të pajisen kopshtet me lojra të ndryshme.
 - c. Të ketë mjete dhe pajisje didaktike, Libra etj
 - d. Të ketë një psikolog në arsimin parashkollor.
 - e. T'I kërkohe qeverisë të mbështesë pushtetin local për këto nevoja pasi më të ardhurat vendore kjo është e mundur. Ai sugjeron, që të mundësohet më shumë vëmendje për arsimin nga qeveria. Mbase një buxhet i vecantë do ndihmonte në këtë drejtim.

4. **Znj.Lindita Nika**, drejtoreshë e shkollës "Mati Logoreci" nënvizon
 - f. Baza materiale (banka,karrige,tabela) në shkollën që ajo drejton ka nevojë për përmirësim, sepse janë të amortizuara dhe ka nevojë për zëvendësim.
 - g. Në ambientet e shkollës ka shumë lagështirë.
 - h. Këndi sportiv ka nevojë për rikonstrukcion të menjëhershëm.

- i. Sistemi i ngrohjes bëhet me gaz dhe nuk është aspak i sigurtë.
 - j. Kabinetet e lendëve përkatëse kanë nevojë për ndërhyrje.
 - k. Kemi nevojë për mjete didaktike të posaçme për fëmijët me aftësi ndryshe.
5. **Z.Anton Deda** shprehet shqetësimin e tij për shkollën e mesme "Jordan Misja". Ai nënvizon që:
- a. Të zgjidhet problem i rojeve sepse po krijohen situata shume të pakëndshme.
 - b. Ai shprehet gjithashtu se investimet në këtë shkollë kanë qenë të kënaqshme dhe mendon se në lidhje me ndërhyrjen në shkollën "Martin Camaj" nuk është momenti i duhur për investim sepse kjo do pengonte në nje process të rregullt mësimor.
6. Fjala i jepet **Z.Vilson Peshkaj** i cili shpreh shqetësimet e tij në lidhje me zonën e Ish Fermentimit:
- a. Kjo zonë nuk ka as cerdhe as kopësht për femijë.
 - b. Refencat e vetme mbi numrin en banorëve janë nga kisha.
 - c. E vetmja menyre transporti për në shkollë është shërbimi urban.
 - d. Ekzistojnë disa godina në zonë që mund të përshtaten në kopshte,qendra rinore etj me pak investim.
 - e. Zona ka nevojë që të ofrohen shërbime të ndryshme

II: MENAXHIMI I MBETJEVE

1. **Z.Ademi** bën një paraqitje të thjeshtë të shërbimit, shtron pyetjen në lidhje me shqetësimet dhe problematikat e zonës në lidhje me mbetjet.Ajo kërkon të dijë nëse shërbimi është i kënaqshëm dhe a ka nevojë për shtim të koshave dhe të frekuences.
2. **Z.Gjin Sokoli** , banor i lagjes Skenderbeg fjalën dhe kërkon:
 - a. Që të vendosen kontinjerë tek rruga ish fusha e lëkurave.
 - b. Rruga ka nevojë pëe ndërhyrje sepse është ë amortizuar dhe mungon edhe ndricimi.
3. **Z.Tonet Shoshi**, inspektor i rajonit nr.3 propozon që koshat plastik duhen zëvendësuar sepse kanë rezultuar jo cilësor. Po ashtu ai shton se duhen edhe makina të vogla për pastrimin e zonave të ngushta sepse të medhatë e kanë të pamundur të hyjnë aty. Ai mendon që duhet patur parasysht në lidhjen e kontratën me firmën kontraktuese.
4. **Z.Emiljano Cekini, banor i lagjes**, merr fjalën dhe përsërit problemin e koshave. Ai kërkon:
 - a. Tek Zona e Stacionit të mallrave ka nevojë për ndërhyrje dhe investim sepse është zonë e harruar.Nuk ka as uje, as ndricim dhe as kosha për mbetjet.
 - b. Koshat dhe frekuenca e pastrimit duhet të vlerësohet sipas banorëve aty.

5. **Z.Bardhok Martini** shprehet se edhe në zonën e tij të banimit nuk ka kosha, se banorët aty i nxjerrin mbeturinat në fund të rrugës me karroca ,ku dhe pastrohen nga firma pastruese. Prandaj ai kërkon:
 - a. Pajisjen me kosha në rrugën “Gjovalin Gjadri” dhe tek rrugica e Poligonit.
6. Edhe **Z.Anton Deda** Propozon që punonjësit e bashkisë duhet të bëjnë një vlerësim dhe verifikim më të saktë në lidhje me pastrimin që të kërkojmë kështu edhe mbështetje.
7. **Z.Lindita Nika** , shpreh shqetësimin e saj në lidhje me shkollën “Mati Logoreci” dhe kërkon:
 - a. Që të merremtohet muri rrethues i shkollës sepse është vjetëruar mbulesa prej eterniti dhe po ashtu edhe godina.
8. **Znj.Aurora Dibra**, banore e lgj.nr 3, shprehet dhe propozon qe:
 - a. Mund të pilotohej ndoshta duke filluar në grupe pallatesh edhe diferencimi i mbetjeve.
 - b. Krahas komunitetit edhe vetë bashkia, ti perfshijë institucionet për grumbullim të diferencuar të mbetjeve.
9. **Z.Ardian Parubi**, banor i zonës së Ish Fermentimit, shpreh shqetësimin e tij në lidhje me mbeturinat. Ai thotë pranë zonës ku banon ka dalje në lumin Kir,dhe makina të ndryshme hedhin mbeturinat në lumë, shpesh herë edhe i djegin dhe kjo është shumë shqetësuese për to.Edhe në rrugën Brioti,thotë ai ka grumbull të madh mbeturinash. Ai propozon qe:
 - a. Që të bëhen verifikim dhe të mundësohet ndoshta vendosja e pjesëve penguese betoni.
 - b. Tjetër shqetësim i banorëve të lagjes nr.3 është transporti i fëmijëve në shkolla, dhe subvencionimi i studentëve.
 - c. Edhe tarifa për shfrytëzim i hapësirës publike të rishikohet sipas sezonit.

III: NDRICIMI RRUGOR

1. **Z.Emiliano Çekini** merr fjalën dhe thotë:
 - a. Ka nevojë për zëvendësim të shtyllave të dëmtuara nga incidente të ndryshme te Rr.Palok Nika.
 - b. Një pjesë e Unazës lindore ka problem sepse mungon ndricimi.
2. **Z.Bardhok Martini**, banor i lagjes nr.3, shpreh shqetësimin e tij në lidhje me zonën e tij të banimit. Aty banojnë rreth 20 familje të ardhura nga zona të thella. Banorët kanë bërë edhe kërkesa me shkrim :Ai propozon që:
 - a. Që të merren masa në lidhje me gropat septike.
 - b. Rrugica e poligonit ka nevojë për rikonstruksion të plotë.
 - c. Rruga ‘Ernest Bushati’, është përfunduar puna me KUZ,por duhet të vazhdohet me shtrimin e tre rrugëve të tjera aty.

3. **Z.Tonet Shoshi** diskuton dhe propozon që:
 - a. Që të bëhet një rikonstruksion i plotë i ndricimit në rrugën ‘Gjuhadol’.
4. **Znj.Julinda Bala** propozon që:
 - a. Të rregullohen shtyllat e prishura në rrugën ‘28 Nëntori’ sepse është shqetësuese aty problemi me shtyllat.

IV: RRJETI RRUGOR

1. Fjala është për **Z.Ded Vatnikaj**, i cili shpreh të njëjtin shqetësim për rrugën ‘Ernest Bushati’
2. Edhe **Z.Adi Parubi**, thotë që kjo është zonë e banuar nga komunitet i ardhur.
Janë shtruar dy rrugë aty: 1) Rruga Brioti dhe 2) Rruga Lodertune. Ai propozon të punohet edhe për tre rrugëve të tjera:
 - a. Rruga ‘Ernest Bushati’
 - b. Rruga ‘Luigj Bebusi’
 - c. Rr. Tom Tonci (ku ndodhet edhe një fasoneri)
3. **Z. Jozef Coba**, kërkon ndërhyrje edhe dy rrugë të tjera të asaj zone:
 - a. Rruga ‘Ludovik Saraci’ deri tek shkolla.
 - b. Rruga ‘Filip Shiroka’
4. **Z.Vilson Pleshka**, inspektor i zonës i cili sqaron se në rrugën ‘Filip Parruca’ përballë Uzinës së Telit banojnë shumë familje që kanë nevojë për shërbime. Ai propozon:
 - a. Të vazhdohet me punimet në atë rrugë (janë bërë KUZ-KUB por nuk ka infrastrukturë nëntokësore), Ka nevojë për ndricim dhe duhet edhe rreth 300 meter shtresë asfalti)
 - b. Rruga ‘Luigj Benusi’ dhe rruga ‘Ernest Bushati’ ka KUZ por nuk ka furnizim me ujë.
5. **Z.Emiljano Cekini** flet në lidhje me problematikat e rrugëve në zonën ku banon ai dhe propozon për:
 - a. Riparimin e disa gropave në rrugën ‘Palok Nika’ dhe tek blloku i pallateve ‘Reshit Rusi’
 - b. Vendosjen e disa bumeve në rrugën pranë stacionit elektrik, tek hyrja e fushës, për të shmangur aksidentet.
 - c. Ndërhyrje edhe në rrugën tek stacioni i mallrave.
6. **Z.Fatjon Ademi**, i cili në lidhje me problematikat e rrjetit rrugor kërkon;
 - a. Ndërhyrjen në rrugën e Gurakuqeve sepse pedonalja është prishur nga ndërtimi i pallateve aty.
 - b. Tek Mehalla e Cakajve ndodhet një shesh pranë shtëpisë së Rusve që ka nevojë për rikonstruksion.
 - c. Ka edhe rrugë të tjera që duhen verifikuar dhe vlerësuar për ndërhyrje.
7. **Z.Bardhok Martini**, rimerr fjalën dhe shton;

- a. Edhe rrugica e Poligonit ka nevojë për rivlerësim sepse ka nevojë për investim më të madh sepse është lënë përgjysëm, nuk ka as KUZ as KUB dhe as ndricim rrugor.
8. **Kurse Z.Cekini** shpreh shqetësim në lidhje me gjobat, ai kërkon;
- a. Sinjalistikë të mirë dhe vendosje vendparkimi sepse qytetarët që kanë bizneset përballë Katedrales marrin shumë gjoba .
9. Edhe **Z.Parubi**, banori i lagjes propozon;
- a. Zëvendësimin e bumeve tek zona pranë Kishës, ka nevojë në çdo dalje rrugice aty.
 - b. Duhet ndërhyrë edhe tek sheshi i pallateve në rrugën ‘Beqir Hebovija’, ish furrat e bukës.
10. Tjetër shqetësim shpreh **Z.Jozef Coba** dhe kërkon;
- a. Të merren masa për lirim të trotuareve, pasi zaptohen me vazo.
 - b. Të hiqen tavolinat e karriket e bizneseve që zënë edhe rrugën.
 - c. Të vlerësohet edhe vendosja e një piston në Gjuhadol.
 - d. Të shtohen bumet në mënyrë që të rregullohet shpejtësia e automjeteve.
 - e. Të pastrohen dhe të tregohet kujdes për shtëpitë e abandonuara aty, që janë një imazh i keq për zonë.
11. **Z.Lindita Nika** merr përsëri fjalën dhe kërkon;
- a. Të vlerësohet infrastruktura e ndriçimi në lagjen “Adem Jashari”
 - b. Në oborrin e pallateve ka shumë probleme me OSHEE.
 - c. Tek oborri i shkollës ‘Mati Logoreci’ duhet ndërhyrë sepse ka probleme me kullimin, ka gjithmonë ujë.

Pyetje dhe diskutime nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

Fisnik Lutfija







BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024
LAGJIA NR.3

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	BEPIN	MHILLI	M	40	SHKODËR	INSPEKTOR	KASHTRI
2	TANJET	Sht.oguri	MASHKULL	37	SHKODËR	INSPEKTOR	KASHTRI
3	DEAD	Utrmitraj	MESHKULL	69	SHKODËR	kompanist	
4	Shelinde	Baba	Femin	32	SHKODËR	ekonomist	big shkodër
5	Shkollë	P. Ico	F	41	SHKODËR	Mësues	Administrative for
6	FARON	ADENI	M	44	SHKODËR	EKONOMIST	UNION BANK
7	Audli	Hollanaj	M	47	SHKODËR	Turist	Privat
8	Gozet	Gosa	M	57	SHKODËR	Privat	privat.
9	Shila	Sebel	SK	56	SHKODËR	SHKODËR	Utraj
10	Nils	Pollaj	M.	63	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
11	Enxhiona	Goshin	M	28	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
12	Audit	Gobaj	M	24	SHKODËR	SHKODËR	SHKODËR
13	Gjoni	Papaj	M	36	SHKODËR	SHKODËR	PAPAJ

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024
LAGJA NR.3

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
14	Adriano	Pesubi	M	36	Fermentim	Pa Punë	Pa Punë
15	Barboshok	Ymeri	M	52	Fermentim	Pa Punë	
16	Beis	Jesh				Just	k. n. l. i. a. l.
17	Autan B	Deda	M	28	Kolej	Speciist	ZVH
18	Eriou	Metushi	M	28	SHKODËR	FUNKONERST	FUNKONERST
19	Surilo,	Millogj	F	48	Shkollë	Mësuese	Drejtores e shkollës
20	Vilson	Peshkaj	M	31	Shkollë	Rrethues ardh.	Shkollë
21	Nohi	Peshko	M	28	SHKODËR	Alternativat privat	Vetpunësim
22	Aferdita	Sinani	F	48	SHKODËR	MF-SUPRISF Drejtores kështj	Drejtores

COORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK